

VENDIM
Nr. 51, datë 18.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 18.10.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ermal (Arben) Gjokja

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1821 (292), datë 3.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi shqiptar Arben Gjokja alias Arben Gjoka, i njohur ndryshe edhe me pseudonimin “Beni”, është hetuar penalisht nga autoritetet italiane për kryerjen në bashkëpunim me të tjerë të veprave penale të parashikuara nga legjislacioni penal italian “Sklavërimi”, “Shfrytëzim prostitucioni” gjatë periudhës shkurt 1999–tetor 2000. Mbi bazën e urdhërarrestit nr. 14601/00 R.G.N.R.-20343 R.G.G.I.P. të gjyqtarit të hetimeve paraprake pranë gjykatës së Veronës, më datë 11.3.2002 Zyra Qendrore Kombëtare (ZKQ) Interpol Roma ka lëshuar urdhërarrestin ndërkombëtar për ndalimin e këtij shtetasi me qëllim ekstradimin e tij drejt shtetit italian.

2. Me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit të Venecias të datës 27.3.2003, ky shtetas është dënuar me 6 vjet burgim dhe 103.688 euro gjobë për kryerjen e veprave penale “Favorizim i hyrjes në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit”, “Favorizim prostitucioni” dhe “Lëndime personale”, të kryera në Verona deri në prill të vitit 2000, si dhe me disa dënime plotësuese. Po kështu, me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit të Venecias të datës 7.5.2003, ai është dënuar me 12 vjet burgim për kryerjen në bashkëpunim të veprave penale “Vendosja ose mbajtja në skllavëri” dhe “Favorizim e shfrytëzim prostitucioni”, të kryera në vende të ndryshme nga data 1.2.1999 deri më datë 5.10.2000, ndërsa me vendimin e formës së

prerë të datës 9.7.2004 të Gjykatës së Breshias, Itali është dënuar me 6 muaj dhe 10 ditë burgim për kryerjen e veprave penale “Lëndime të rënda” dhe “Kundërshtim i oficerit të rendit publik”, të kryera në Breshia, më 8.5.1998.

3. Me vendimin nr. 731/2007 R.E.S., datë 13.6.2007 të Prokurorit pranë Gjykatës së Breshias është vendosur bashkimi i dënimeve të dhëna ndaj këtij shtetasi dhe dënimi përfundimtar i tij me 18 vjet, 6 muaj e 10 ditë burgim, si dhe 103.668 euro gjobë. Në vijim, me urdhrin e ekzekutimit nr. 731/2007 R.E.S., datë 25.9.2007 të prokurorit të Breshias, dënimit të kërkuarit i janë zbritur 3 vjet burgim dhe 10.000 euro gjobë, duke e dënuar përfundimisht me 15 vjet, 6 muaj e 10 ditë burgim, si dhe 93.668 euro gjobë.

4. Me shkresën nr. 773/10, datë 17.11.2008, Prokuroria e Përgjithshme shqiptare i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës materialet për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj këtij shtetasi, çka nuk është realizuar, pasi shtetasi i ndaluar për këtë qëllim Ermal (Arben) Gjokja (*kërkuesi*) nuk rezultonte të ishte personi i gjykuar dhe dënuar nga shteti italian.

5. Më datë 6.11.2014 kërkuesi është ndaluar sërisht në kuadër të kërkesës së ekstradimit të shtetit italian dhe nga akti i ekspertimit nr. 11079, datë 7.11.2014, i Drejtorisë së Policisë Shkencore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë ka rezultuar se gjurmët papilare të gishtave të kërkuarit nuk përputheshin me ato të pasqyruara në kartelën daktiloskopike të policisë italiane, datë 8.5.1998 për shtetasin Arben Gjokja. Me vendimin nr. 892, datë 8.11.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa ka vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë të kërkuarit, ka vendosur caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga nenet 234 dhe 493 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 18.11.2014. Me vendimin e datës 26.2.2015, të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i kërkesës për ekstradim, pasi shtetasi Ermal (Arben) Gjokja nuk ishte personi i deklaruar fajtor e i kërkuar nga drejtësia italiane dhe, pavarësisht kalimit të një periudhe prej 3 muajsh e 20 ditësh nga caktimi i masës së sigurimit për efekt të ekstradimit, Prokuroria e Përgjithshme nuk kishte paraqitur kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për t’i dhënë rrugë ekstradimit.

6. Në vijim, autoritetet italiane kanë paraqitur kërkesën për njohjen e vendimit penal në ngarkim të shtetasit Arben Gjokja, çka nuk është realizuar, pasi personi i ndaluar Ermal Gjokja (kërkuesi) nuk ishte personi i kërkuar nga autoritetet italiane. Këto të fundit janë njoftuar për këtë me shkresë të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Bazuar në urdhrin e ekzekutimit nr. 731/2007 R.E.S., datë 25.9.2007, të prokurorit të Breshias, më datë 16.9.2016 ZQK-ja Interpol Roma ka nxjerrë urdhrin e përditësuar ndërkombëtar të arrestit për shtetasin Arben Gjokja, alias Arben Wokja, alias Arben Gjoka, alias Ermal Gjokja, i njohur edhe me pseudonimin “Beni”. Më datë 26.12.2017 kërkuesi është shoqëruar përsëri në Policinë Vendore Durrës dhe përmes ZQK-së Interpol Tirana i është kërkuar ZQK-së Interpol Roma krahasimi i gjurmëve të gishtave të tij me ato të personit të shpallur në kërkim ndërkombëtar. Në kushtet kur ky krahasim nuk është bërë në kohë nga autoritetet italiane, kërkuesi është liruar. Pas njoftimit të ZQK-së Interpol Roma se gjurmët daktiloskopike të kërkuarit përputheshin me ato personit të shpallur në kërkim ndërkombëtar, përmes Ministrisë së Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë të Italisë riparaqitjen e kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal italian të dhënë ndaj këtij shtetasi. Më datë 6.4.2022 ZQK-ja Interpol Roma ka riparaqitur kërkesën për ekstradim. Më datë 16.4.2022 kërkuesi është arrestuar sërisht dhe nga akti i ekspertimit daktiloskopik nr. 42, datë 17.4.2022 të Seksionit të Policisë Shkencore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës ka rezultuar se gjurmët e gishtave të tij ishin të njëjta me ato të personit në kërkim nga autoritetet italiane.

Procesi i parë për masën e sigurimit

8. Më datë 18.4.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për vleftësimin e arrestit të kërkuarit dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “Arresti në burg” me qëllim ekstradimin drejt shtetit italian. Kërkuesi ka prapësuar, ndër të tjera, se ZQK-të Interpol Roma dhe Interpol Tirana kanë ngatërruar kartelën e tij me atë të personit të kërkuar Arben Gjokja, si dhe se dokumentet e identifikimit personal të tij janë

përdorur nga i vëllai A.H.Xhakja, i vrarë më datë 14.2.1999, i cili i ka përshtatur ato për përdorim vetjak, duke vënë në to fotografinë e tij. Po sipas kërkesës, gjurmët daktiloskopike të tij nuk përputheshin me ato të personit të kërkuar nga autoritetet italiane dhe pavarësisht se çështja e ekstradimit të tij është pushuar dy herë nga prokuroria shqiptare, konkretisht në vitet 2008 dhe 2014, ZQK-ja Interpol Tirana ka vazhduar ta mbajë atë pa të drejtë në kërkim ndërkombëtar, bazuar në kërkimin fillestar të ZQK-së Interpol Roma.

9. Me vendimin nr. (11-2022-311) 257, datë 20.4.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur vleftësimin të ligjshëm të arrestimit të kërkesës dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, në formën arrestit të përkohshëm, me qëllim paraqitjen e kërkesës për ekstradim nga autoritetet italiane të drejtësisë brenda afateve ligjore të parashikuara nga neni 494, pika 6, i KPP-së dhe neni 16, pika 4, i Konventës Evropiane për Ekstradimin (KEE), të ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998. Kjo gjykatë, duke pasur parasysh parashikimet e nenit 493/2 të KPP-së për caktimin e masave të sigurimit për qëllime të ekstradimit, sipas titullit V të këtij kodi, për aq sa ato mund të zbatohen, si dhe ndryshimin mes masave të sigurimit personal në kushte të zakonshme dhe atyre të caktuara për qëllime të garantimit të ekstradimit, ka vlerësuar se në kuptim të nenit 228 të KPP-së, ndaj kërkesës ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale për të cilën është lëshuar urdhërarresti ndërkombëtar. Sipas gjykatës, veprat penale për të cilat ai akuzohet sipas Kodit Penal italian janë të dënueshme edhe sipas Kodit Penal shqiptar (KP) dhe, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuesi, sipas aktit të ekspertimit daktiloskopik nr. 42, datë 17.4.2022, gjurmët e gishtave të tij janë të njëjta me ato të personit në kërkim nga autoritetet italiane. Për rrjedhojë, masa më e përshtatshme e sigurimit është “Arresti në burg”, e parashikuar në nenin 238 të KPP-së. Kërkuesi ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi. Me vendimin nr. (10-2022-889) 178, datë 18.5.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur miratimin e vendimit nr. (11-2022-311) 257, datë 20.4.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke çmuar se ai është marrë në zbatim të drejtë të ligjit.

Procesi i dytë për masën e sigurimit

10. Më datë 25.5.2022, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për revokimin e masës së përkohshme të sigurimit personal të caktuar ndaj tij, duke pretenduar, ndër të tjera, se mungojnë deklarami i shtetit italian për paraqitjen e kërkesës për ekstradim, si dhe vetë kërkesa; edhe në rast të paraqitjes së kërkesës masa e sigurimit duhet revokuar në zbatim të parimit *ne bis in idem*; ai nuk është personi i kërkuar nga autoritetet italiane; kartela e re e përditësuar nga ZQK-të Interpol Roma dhe Interpol Tirana përmban gjurmët papilare të marra nga autoritetet italiane më datë 8.5.1998, shtetasit Arben Xhakja. Përpara tërheqjes së gjykatës në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit, prokurori i çështjes ka paraqitur kërkesën e autoriteteve italiane për ekstradimin e kërkesës, së bashku me aktet shoqëruese.

11. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. (11-2022-2580) 257/1, datë 26.5.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kërkuesi ka ushtruar ankim, duke pretenduar, ndër të tjera, se masa e sigurimit kishte humbur fuqinë e saj juridike, pasi autoritetet italiane nuk kishin paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë shqiptare kërkesën për ekstradim brenda afateve të parashikuara. Me vendimin nr. (10-2022-1044) 223, datë 21.6.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur miratimin e vendimit të gjykatës së rrethit. Në vijim, më datë 15.7.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për zgjatjen e afatit të masës së sigurimit të dhënë ndaj kërkesës për një periudhë 1-mujore. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, me vendimin nr. (11-2022-3565) 257/1, datë 16.7.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur zgjatjen e afatit të masës së sigurimit “Arresti në burg” të dhënë me vendimin e saj nr. (11-2022-311) 257, datë 20.4.2022, për një periudhë 30-ditore, duke filluar nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 2.8.2022.

Procesi në lidhje me procedurën e ekstradimit

12. Më datë 24.5.2022, Ministria e Drejtësisë italiane u është drejtuar autoriteteve shqiptare me kërkesë për ekstradimin e kërkesës. Më datë 26.5.2022, bazuar në nenet 492, 497 e vijues të KPP-

së, prokurori i çështjes i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për ekstradimin e kërkuarit drejt shtetit italian. Me vendimin nr. (11-2022-3627) 247, datë 18.7.2022, gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradimin e kërkuarit, duke arsyetuar, ndër të tjera, se ekzekutimi i dënimit është parashkruar sipas nenit 68, shkronja “b”, të KP-së, pasi nga momenti i dhënies së vendimit nga gjykatat italiane kanë kaluar më shumë se 10 vjet, çka përbën shkak për moslejimin e ekstradimit sipas nenit 491, shkronja “ë”, të KPP-së; kërkuari është gjykuar në mungesë dhe nga autoritetet italiane nuk është dhënë garanci për rishikimin e vendimeve të dënimit, rrethanë kjo e parashikuar nga neni 491, shkronja “P”, i KPP-së; nga aktet e administruara nuk provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se personi i dënuar nga gjykatat italiane është i arrestuari Ermal (Arben) Gjokja, pasi ndaj tij rezultojnë dy akte të ndryshme daktiloskopike, ndërkohë që nga prokuroria duhej të ishte urdhëruar ekspertimi me grup ekspertësh me qëllim që akti i përpiluar nga këta të fundit të prevalonte ndaj akteve të kryera me një ekspert; gjeneralitetet e personit të kërkuar nga autoritetet italiane nuk përputhen me gjeneralitetet e të arrestuarit Ermal (Arben) Gjokja; saktësimi i gjeneraliteteve i bërë nga Interpoli nga Gjokja në Gjokja nuk është në përputhje me nenin 385 të KPP-së, sipas të cilit ndreçja e gabimit bëhet vetëm nga gjykata që ka dhënë vendimin; dënimi penal i kërkuarit është dhënë nga gjykatat italiane përpara miratimit e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Ekstradimit mes shtetit italian dhe atij shqiptar, e cila nuk ka fuqi prapavepruese; kërkesa për ekstradim përbën gjë të gjykuar, pasi me vendimin e datës 26.2.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushimi i kërkesës për ekstradim, për shkak se Ermal (Arben) Gjokja nuk ishte personi i kërkuar nga drejtësia italiane; edhe sipas jurisprudencës kushtetuese kur një vendim gjyqësor nuk e ka lejuar ekstradimin në zbatim të nenit 498/4 të KPP-së, kërkesa për ekstradim nuk mund të rishqyrtohet, me përjashtim të rasteve kur paraqiten elemente të reja në kërkesën për ekstradim, çka nuk rezulton në rastin konkret.

13. Kundër vendimit të gjykatës së rrethit ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa kërkuari kundërankim. Për qëllime të gjykimit të çështjes, gjykata e apelit ka riçelur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor. Në përfundim të gjykimit, pas vlerësimit të fakteve, provave dhe pretendimeve të palëve, me vendimin nr. 10-2022-1888 (374), datë 13.12.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Sipas saj, arsyetimi i gjykatës së rrethit për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit është i pabazuar, pasi, për qëllime të ekstradimit, ky parashkrim ndjek kufijtë e parashikimit ligjor të shtetit kërkuar dhe jo nenit 68 të KP-së shqiptare. Sipas dispozitës penale të shtetit kërkuar, ekzekutimi i dënimit parashkruhet me kalimin e dyfishit të masës së dënimit të dhënë, çka nuk rezulton në rastin konkret. Po kështu, ndonëse i dënuari është gjykuar në mungesë dhe nga ana e shtetit italian nuk janë dhënë garanci për rishikimin e vendimeve të dënimit, ai ka pasur përfaqësim ligjor me avokat dhe ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit, çka tregon se nuk i është mohuar e drejta për proces të rregullt ligjor. Për më tepër, dispozitat ligjore të referuara nga shteti kërkuar parashikojnë mundësinë e rigjykimit. Po sipas gjykatës, arsyetimi i gjykatës së rrethit për mungesën e fuqisë prapavepruese të marrëveshjes së ekstradimit mes shtetit italian dhe atij shqiptar është i pabazuar, pasi dispozitat e ligjit shqiptar miratues të saj kanë karakter procedural penal dhe jo material. Vetëm këto të fundit nuk mund të kishin fuqi prapavepruese. Gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar edhe arsyetimin e gjykatës së rrethit në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar, pasi, sipas saj, për të përbërë gjë të gjykuar, faktet e rezultuara gjatë trajtimit të kërkesës së autoriteteve italiane të drejtësisë përpara prokurorisë shqiptare duhet t'i ishin nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe për të konfirmuar qëndrimin e prokurorit se nuk ka vend për vijimin e ekstradimit. Po kështu, Gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit, për sa i përket shkakut ligjor të mosidentifikimit të personit të kërkuar nga autoritetet italiane. Pas verifikimit zyrtar të saj në lidhje me personin e kërkuar, gjykata ka konkluduar se të dhënat e aktit të ekspertimit daktiloskopik nr. 42, datë 17.4.2022, nuk janë të besueshme në drejtim të identifikimit të personit të dënuar nga autoritetet italiane dhe që duhet të ekstradohet, pasi konkluzionet e tij jo vetëm që bien ndesh me konkluzionet e akteve të mëparshme të ekspertimit daktiloskopik, por gjurmët e përdorura për krahasim nuk kanë asnjë origjinë të verifikueshme që t'i lidhë ato me procedimet penale të zhvilluara në Itali dhe personin ndaj të cilit janë dhënë vendimet penale.

14. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, ndërsa kërkuasi kundërrekurs. Me vendimin nr. 00-2023-1099 (195), datë 30.6.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues, duke vlerësuar, ndër të tjera, se refuzimi i ekstradimit nga gjykatat më të ulëta nuk mbështetet në asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 491 të KPP-së dhe motivimet e vendimmarrjes refuzuese përtej shkaqeve të përcaktuara në këtë dispozitë, në veçanti nga gjykata e apelit, ishin haptazi të pabazuara. Sipas Kolegjit Penal, problematika në lidhje me mosidentifikimin e personit të kërkuar ka rezultuar vetëm në lidhje me dënimin prej 6 muajsh e 10 ditësh burgim të dhënë nga Gjykata e Breshias, ndërsa në lidhje me dy dënimet e tjera të dhëna nga Gjykata e Apelit të Venecies dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Venecie, për të cilat kërkohet ekstradimi, nuk vërehet asnjë problematikë ose pengesë nga ato të parashikuara nga neni 491 i KPP-së në drejtim të individualizimit të veprimtarisë kriminale të zhvilluar prej tij, sipas akuzës, dhe të verifikuar në gjykim. Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit Durrës nuk kishte asnjë ndalesë të procedonte me ekstradimin edhe vetëm për ekzekutimin e këtyre dy dënimeve (*shih vendimin nr. 00-2023-1099 (195), datë 30.6.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, paragrafët 16–24*).

15. Sipas shkresës nr. 12947/1, datë 29.9.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton se çështja është regjistruar në këtë gjykatë më datë 7.9.2023 është shortuar dhe deri më datë 28.9.2023 nuk është planifikuar për gjykim.

Procesi i tretë për masën e sigurimit (objekt i ankimit kushtetues individual)

16. Në kushtet kur gjykata e rrethit ka vendosur moslejimin e ekstradimit, më datë 18.7.2022 kërkuasi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë të re për revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit personal dhe konstatimin e shuarjes së saj, për të cilën gjykata, me vendimin nr. (11-2022-3706) 257/2, datë 25.7.2022, ka vendosur rrëzimin, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata ka vlerësuar se kërkesa për shuarjen e masës ishte e parakohshme, pasi afati 30-ditor i caktuar prej saj me vendimin nr. (11-2022-2580) 257/1, datë 16.7.2022, mbaronte më datë 15.8.2022; vendimi i gjykatës së rrethit që ka vendosur moslejimin e ekstradimit të kërkuarit nuk ka marrë formë të prerë, pasi është ankimuar nga prokuroria; kërkesës nuk i janë bashkëlidhur prova dhe akte për të provuar pretendimet; pretendimet për zbatimin e nenit 261 të KPP-së janë të pabazuara, pasi mospranimi i kërkesës për ekstradim nuk përfaqëson as pushim e as pafajësi për të arrestuarin; ligjvënësi nuk është shprehur se në rastet e moslejimit të ekstradimit nga gjykata e shkallës së parë i arrestuari duhet të lirohet dhe neni 499, pika 2, i KPP-së nënkupton rastin kur vendimi që refuzon kërkesën për ekstradim është i formës së prerë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuasi.

17. Me vendimin nr. (10-2022-1247) 265, datë 5.8.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. (11-2022-3706) 257/2, datë 25.7.2022, të gjykatës së rrethit. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se pretendimet e kërkuarit për shuarjen e masës së sigurimit janë të pabazuara, pasi qëllimi i zbatimit të këtyre masave shtrënguese është garantimi i dhënies së ndihmës juridike të kërkuar nga shteti kërkuar, e pikërisht mundësia e dorëzimit të personit të kërkuar në eventualitetin e pranimin të kërkesës për ekstradim. Ndryshimet ligjore të bëra në KPP me ligjin nr. 35/2017 kanë përcaktuar mundësinë e dhënies rrugë ekstradimit nga Ministri i Drejtësisë vetëm pasi vendimi të marrë formë të prerë dhe vendimi është i tillë vetëm pasi është shqyrtuar edhe nga Gjykata e Lartë, nëse nga palët është ushtruar rekurs. Po sipas gjykatës, neni 261, pika 1, KPP-së bën fjalë për shuarjen e një mase sigurimi të caktuar për llogari të një procedimi penal dhe gjykimi themeli në kompetencë të gjykatës vendase, ndërsa procedura gjyqësore e shqyrtimit të kërkesës për ekstradim është tërësisht e ndryshme, pasi vendimi i dënimit ose i caktimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” i përket autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkuar. Garancia ligjore e parashikuar në këtë rast është kohëzgjatje e ndryshme e masës së sigurimit në raport me kohëzgjatjen e gjykimit, në ndryshim nga përcaktimi i përgjithshëm në nenin 263 të KPP-së. Pretendimet e kërkuarit për lirimin e tij bazuar në nenin 499 të KPP-së, për shkak të rrëzimit të kërkesës për ekstradim, janë të pabazuara, pasi kjo dispozitë nuk ka lidhje me fazën gjyqësore të shqyrtimit të një kërkesë për ekstradim, por i referohet qartësisht fazës pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor që ka lejuar ekstradimin. Po kështu, pretendimi i

kërkuesit se duhet të lirohet, pasi gjykata e shkallës së parë ka pranuar se vendimi i gjykatës italiane është dhënë për person të gabuar, është i pabazuar, pasi neni 261, pika 1, i KPP-së bën fjalë për gjykim themeli, në lidhje me akuza të hetuara e të gjykuara nga autoritetet shqiptare. Për më tepër, sipas qëndrimit orientues të mbajtur me vendimin nr. 00-2022-787, datë 5.7.2022, të Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë, vendimi i pafajësisë nuk ndikon në caktimin e masës së sigurimit.

18. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimeve të lartpërmendura. Për shkak të rëndësisë së problematikës së çështjes nga pikëpamja e së drejtës dhe në funksion të zhvillimit të praktikës gjyqësore Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 00-2022-1821 (292), datë 3.11.2022, kolegji ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. (10-2022-1247) 265, datë 5.8.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se kërkesa për ekstradim është e lidhur ngushtësisht me caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues, me qëllim të garantimit që personi për të cilin kërkohet ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit; pretendimi i kërkuesit për mungesën e rrezikut të largimit, sipas nenit 228, pika 3, shkronja “b”, të KPP-së, është i pabazuar, pasi vendimi i gjykatës së rrethit që ka disponuar për ekstradimin është ankimuar nga prokurori, për rrjedhojë nuk ka marrë formë të prerë; sipas parashikimeve të KPP-së pas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, vendimi për çështjen e ekstradimit merr formë të prerë në Gjykatën e Lartë, çka i bën inefektive parashikimet e nenit 261 të KPP-së, për rrjedhojë paragrafi i dytë i nenit 499 të po këtij kodi merr kuptim vetëm me fitimin e statusit të “gjësë së gjykuar”; procedura gjyqësore e shqyrtimit të kërkesës për ekstradim është tërësisht e ndryshme nga shqyrtimi i elementeve të fajësisë ose pafajësisë; pretendimi i kërkuesit për mbajtjen e dy standardeve nga gjykata e apelit është i pabazuar, pasi kjo gjykatë ka arsyetuar se nuk gjendej përpara kushteve të nenit 261/1, shkronja “a”, të KPP-së, por edhe nëse do të ishte përpara këtyre kushteve, në vendimin nr. 00-2022-787, datë 5.7.2022, Gjykata e Lartë ka legjitimuar zbatimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues gjatë gjykimit të akuzës edhe në kushtet e deklaramit të pafajësisë së të pandehurit.

Procesi i katërt për masën e sigurimit

19. Më datë 15.12.2022, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit, urdhërimin e lirimit të tij, revokimin ose zëvendësimin e masës. Me vendimin nr. (11-2022-6287) 257/3, datë 17.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pranimin e kërkesës; konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal “Arresti në burg” të caktuar prej saj me vendimin nr. (11-2022-311) 257, datë 20.4.2022, lënë në fuqi nga gjykata e apelit për shkak të rrëzimit të kërkesës për ekstradimin e kërkuesit në shtetin italian me vendimin e kësaj gjykate, të lënë në fuqi nga gjykata e apelit; urdhërimin e lirimit të menjëhershëm të kërkuesit. Me vendimin nr. 344, datë 27.3.2023, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. (11-2022-6287) 257/3, datë 17.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për shuarjen e masës së sigurimit, ndërsa me vendimin nr. 00-2023-1341, datë 24.7.2023, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

20. Më datë 16.5.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të dhënë gjatë procesit të tretë gjyqësor të iniciuar për kundërshtimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj tij, duke pretenduar se i ka cenuar të drejta kushtetuese. Kolegji i Gjykatës, më datë 18.7.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

21. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

21.1 *Liria personale*, si rrjedhojë e vendimmarrjeve të gjykatave për caktimin ndaj tij të masës së

sigurimit personal “Arresti në burg”, ndonëse është vendosur rrëzimi i kërkesës së autoriteteve të shtetit italian për ekstradimin e tij, rrethanë kjo që tregon se ekzistenca e dyshimit për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit ka rënë. Rrëzimi i kërkesës për ekstradim duhej të shoqërohej me revokimin ose zëvendësimin e masës me karakter shtrëngues, çka nuk ka ndodhur në rastin e tij.

21.2 *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit*, pasi rasti i referuar për analogji nga gjykata e apelit ka të bëjë me gjykim themeli, pra me situatë tjetër ligjore, që nuk mund të shërbejë si referencë për përligjen e vendimmarrjes së saj. Gjykata e apelit rrëzon kërkesën e mbrojtjes për pushimin e çështjes penale, sipas nenit 261/1 të KPP-së, për shkak të rrëzimit të kërkesës për ekstradim, me arsyetimin se parashikimi i kësaj dispozite ka të bëjë me çështje të themelit, ndërsa referon si interpretim mbështetës e orientues vendimin nr. 00-2022-787, datë 5.7.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka lidhje me çështjen objekt gjykimi.

21.3 *Parimi i ligjshmërisë*, pasi gjykatat kanë keqinterpretuar nenin 499 të KPP-së. Ndonëse në këtë dispozitë ligjvënësi nuk është shprehur se kur urdhërohet lirimi i të arrestuarit, liria personale prevalon në çdo shkallë gjykimi, pavarësisht marrjes formë të prerë ose jo të vendimit. Në rastet e ekstradimit vendimi merr formë të prerë në Gjykatën e Lartë vetëm në rastet kur gjykata e apelit ka dhënë vendim për lejimin e ekstradimit dhe vendimi i saj ankimohet në Gjykatën e Lartë nga individ i që do të ekstradohet. Qëndrimi që gjykatat kanë mbajtur ndaj tij bie ndesh edhe me praktikën gjyqësore të deritanishme.

21.4 *Parimi ne bis in idem*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka rrëzuar për herë të dytë kërkesën për ekstradimin e tij, i cili edhe herën e parë nuk është ekzekutuar, pasi vendimi i autoriteteve italiane të drejtësisë nuk është dhënë ndaj tij.

21.5 *Parimi i sigurisë juridike*, për shkak të:

21.5.1 Arsytimit të gjykatave se jurisprudenca lejon ricaktimin e masës ndaj një individ të cilit i është shuar masa.

21.5.2 Mbajtjes së dy standardeve nga gjykata e apelit, pasi kjo gjykatë ka vendosur caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal edhe pse ka arsyetuar për vendimin e gjykatës së rrethit, përmes të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës për ekstradim, si dhe për faktin se çështja përbën gjë të gjykuar.

22. ***Subjekti i interesuar***, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi me vendimin nr. 257/3, datë 17.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur konstatimi i shuarjes së masës së sigurimit personal “Arresti në burg” të caktuar ndaj tij, duke u urdhëruar lirimi i menjëhershëm. Në kushtet kur e drejta e pretenduar si e shkelur është rivendosur, gjykimi kushtetues ka mbetur pa objekt dhe vendimi i Gjykatës nuk mund të sjellë më pasoja në të drejtat e tij. Edhe rigjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, në eventualitetin e shfuqizimit të vendimit të kësaj gjykate nga Gjykata, do të mbetej pa objekt.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

23. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

24. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja

“i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

25. Detyrimi për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, është trajtuar nga Gjykata si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur procesin gjyqësor, ashtu edhe të atyre të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Lidhur me këto të fundit, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procedurat gjyqësore për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg” për qëllime të ekstradimit, të cilat kanë përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1821 (292), datë 3.11.2022. Ndonëse në objekt të kërkesës ai kundërshton këtë vendim, në përmbajtje të saj ka kundërshtuar edhe vendimet e gjykatave më të ulëta, pretendimet për të cilat i ka parashtruar, në thelb, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

27. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, Gjykata vëren se sipas shkresës nr. 2149/1, datë 26.4.2023 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, të depozituar nga kërkuesi së bashku me ankimin kushtetues individual, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 3.11.2022, është bërë i disponueshëm për palët më datë 17.1.2023, ndërsa kërkesa drejtuar Gjykatës është paraqitur më datë 16.5.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

28. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e lirisë personale, së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit, parimit të ligjshmërisë, parimit *ne bis in idem*, si dhe të parimit të sigurisë juridike. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi me vendimin nr. 257/3, datë 17.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur konstatimi i shuarjes së masës së sigurimit personal “Arresti në burg” të caktuar ndaj tij, duke u urdhëruar lirimi i menjëhershëm. Po sipas këtij institucioni, në kushtet kur e drejta e pretenduar si e shkelur është rivendosur, gjykimi kushtetues ka mbetur pa objekt dhe vendimi i Gjykatës nuk mund të sjellë më pasoja në të drejtat e tij.

29. Pavarësisht sa ka pretenduar subjekti i interesuar, Gjykata vëren se vendimi nr. 257/3, datë 17.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është ndryshuar me vendimin nr. 344, datë 27.3.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke u vendosur rrëzimi i kërkesës së kërkuesit për shuarjen e masës së sigurimit. Po kështu, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se me vendimin nr. 00-2023-1341, datë 24.7.2023, të Kolegjit Penal të kësaj gjykate është vendosur mospranimi i rekursit të kërkuesit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Duke pasur parasysh edhe qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Hysa kundër Shqipërisë*, nr. 52048/16, datë 21.2.2023, sipas të cilit Gjykata është e detyruar të shqyrtojë rastet e kufizimit të lirisë personale pavarësisht faktit nëse i pandehuri ndodhet në kushtet e kufizimit të kësaj lirie ose jo, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e ngritura, ndaj prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, në këtë drejtim janë të pabazuara.

30. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae* të kërkuesit, Gjykata vëren se pretendimet për parimin e ligjshmërisë kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e lirisë personale, të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit, parimit *ne bis in idem*, si dhe të parimit të sigurisë juridike, të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues, Gjykata vlerëson se ato për cenimin e parimit *ne bis in idem* nuk janë ngritur në nivel kushtetues, ndërsa ato për cenimin e parimit të sigurisë juridike kanë të bëjnë me standardin e arsytimit të vendimit. Në këto kushte, duke pasur parasysh thelbin e pretendimeve

të kërkuarit, Gjykata çmon se pretendimet për cenimin e lirisë personale dhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit t'i analizojë në themel të lidhura së bashku në drejtim të lirisë personale në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit.

B. Për themelin e pretendimeve

Për cenimin e lirisë personale në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit

31. Kërkuari ka pretenduar se i është cenuar liria personale si rrjedhojë e vendimmarrjeve të gjykatave për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, ndonëse gjykata e rrethit dhe ajo e apelit kanë vendosur mospranimin e kërkesës së shtetit italian për ekstradimin e tij. Sipas tij, në rrëzimin e kërkesës për ekstradim gjykatat duhet të shpreheshin edhe për revokimin ose zëvendësimin e masës me karakter shtrëngues, çka nuk ka ndodhur në rastin e tij. Gjykatat kanë keqinterpretuar nenin 499 të KPP-së, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm nga praktika gjyqësore e deritanishme. Rasti i referuar për analogji nga gjykata e apelit ka të bëjë me gjykim themeli, pra me situatë tjetër ligjore, që nuk mund të shërbejë si referencë për përligjjen e vendimmarrjes së saj. Çështja e ekstradimit të tij është rrëzuar edhe më parë nga gjykatat dhe kërkesa për ekstradim nuk është ekzekutuar nga Policia Gjyqësore, pasi vendimi i autoriteteve italiane të drejtësisë ishte dhënë ndaj një individi të gabuar.

32. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka pretenduar se kërkuari nuk legjitimohet *ratione materiae*, duke mos parashtruar prapësime në themel për pretendimet e kërkuarit.

33. Gjykata vëren se ekstradimi parashikohet drejtpërdrejt nga Kushtetuta, neni 39, pika 2, i së cilës përcakton se ai mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Referuar KEE-së dhe KPP-së, ekstradimi konsiston në një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale. Për qëllime të realizimit të procedurës së ekstradimit, në raste urgjente, neni 16 i KEE-së ka parashikuar edhe arrestimin e përkohshëm të personit të kërkuar, bazuar në kërkesën e shtetit kërkuar, e cila vlerësohet nga autoritetet kompetente të shtetit që i drejtohet në përputhje me ligjin e këtij shteti. Sipas pikës 4 të këtij neni, arrestimi i përkohshëm mund të marrë fund nëse brenda një afati prej 18 orësh pas arrestimit, pala e kërkuar nuk ka marrë kërkesën për ekstradim dhe dokumentet shoqëruese. Ai nuk duhet të kalojë, në asnjë rast, 40 ditë nga data e arrestimit. Kjo dispozitë njihet, gjithashtu, të drejtën e shtetit të kërkuar për të vendosur lirimin e përkohshëm të personit të kërkuar, me kusht që ai të marrë çdo masë që e quan të nevojshme për të shmangur arratisjen e tij. Detyrimet e KEE-së në lidhje me ekstradimin e shtetasve shqiptarë për në shtetin italian dhe anasjelltas janë përforcuar më tej në marrëveshjen dypalëshe të nënshkruar mes këtyre shteteve, të ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008.

34. Ndërkohë, neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, ndërsa shkronja “dh” e pikës 2 të këtij neni parashikon ekstradimin si një ndër rastet e kufizimit të lirisë personale. Kufizimi i lirisë personale për qëllime të ekstradimit të personit të kërkuar në shtetin kërkuar parashikohet, gjithashtu, edhe në nenin 5, pika 1, shkronja “f”, të KEDNJ-së. Ndërkohë, procedurat e kufizimit të lirisë personale parashikohen në mënyrë të detajuar në KPP.

35. Po ashtu, edhe në jurisprudencën e saj në lidhje me kufizimin e lirisë personale, Gjykata është shprehur se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012; nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata vëren se karakteri gjyqësor i procedurave për caktimin e masave të sigurimit përcaktohet nga neni 28 i Kushtetutës, i cili përfshin edhe masat e caktuara sipas nenit 27, pika 2, shkronja “dh”, të Kushtetutës. Si të tilla, këto procedura duhet të respektojnë garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, përfshirë standardin e arsyetimit të vendimit. Në jurisprudencën e saj në drejtim të këtij standardi, Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor

të arsyetuar i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 21, datë 26.9.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në zbatim të dispozitave kushtetuese që përcaktojnë ekstradimin dhe kufizimin e lirisë personale për këtë qëllim, si dhe detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, caktimi i masave shtrënguese për qëllime të ekstradimit ka gjetur rregullim nga ligjvënësi në nenet 493–495 të KPP-së, si dhe në nenet 35 e 36 të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar (*ligji nr. 10139/2009*). Sipas nenit 493, pika 2, të KPP-së, në caktimin e masave shtrënguese të sigurimit personal respektohen dispozitat e Titullit V të këtij kodi, për aq sa mund të zbatohen, duke mbajtur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit, ndërsa sipas nenit 499, pika 2, të KPP-së, personi lirohet edhe në rast refuzimi të kërkesës së ekstradimit. Nga ana e tyre, dispozitat e Titullit V të KPP-së kërkojnë ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe përmbushjen e disa kriterëve të veçanta në caktimin e masave të sigurimit, dispozita këto që kanë gjetur pasqyrim edhe në nenet 35 dhe 36, të ligjit nr. 10139/2009.

38. Nën dritën e standardeve kushtetuese për rastet e kufizimit të lirisë personale të individit, Gjykata çmon të vlerësojë në aspektin kushtetues vendimmarrjet e gjykatave në kontekstin e fakteve të çështjes në shqyrtim. Në këtë drejtim, bazuar në materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues të çështjes, Gjykata konstaton se liria e kërkuarit është kufizuar në 16.4.2022, kur, bazuar në urdhrin e përditësuar të arrestit ndërkombëtar, ai është arrestuar për qëllime të ekstradimit në shtetin italian.

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, Gjykata e Lartë ka vlerësuar interpretimin që gjykatat më të ulëta u kanë bërë dispozitave ligjore të KPP-së që rregullojnë caktimin e masave shtrënguese për qëllime të ekstradimit, për aq sa ato mund të zbatohen, duke pasur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit. Kjo gjykatë ka theksuar lidhjen e ngushtë të kërkesës për ekstradim me caktimin e masave shtrënguese të sigurimit personal, natyrën e veçantë të procedurës së caktimit të këtyre masave në raste të tilla përkundrejt caktimit të masave shtrënguese në rastet e procedimit tipik penal, qëllimin e ligjvënësit në rregullimin ligjor të nenit 493, paragrafët 3 dhe 4, për kushtëzimin e caktimit të masës me ecurinë e procedurës së ekstradimit, si dhe karakterin e përkohshëm të kësaj mase e zbatimin e saj deri në marrjen formë të prerë të vendimit për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim (*shih vendimin nr. 00-2022-1821 (292), datë 3.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqet 13–14, paragrafët 16–19*).

40. Po ashtu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural dhe duhej të lihej në fuqi. Kështu, në interpretim të nenit 462, pika 3, shkronja “c”, të KPP-së, kjo gjykatë ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit në lidhje me vendimmarrjen jopërfundimtare të gjykatës së shkallës së parë për çështjen e ekstradimit, duke vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkuarit të ngritura në rekurs për shuarjen e saj në zbatim të nenit 228, pika 3, shkronja “b”, të KPP-së. Kolegji Penal ka vlerësuar se kjo vendimmarrje nuk sjell efekt, pasi ligjvënësi i ka shtrirë efektet e procedurës në të tria shkallët e gjykimit, duke konsideruar “gjë të gjykuar” vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë. Po kështu, Kolegji Penal i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkuarit për zbatimin në rastin e tij të dispozitave të nenit 261/1, shkronja “a”, të KPP-së dhe mbajtjen e dy standardeve nga gjykata e apelit në zbatimin e këtij neni. Kolegji Penal ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit për mosgjethjen zbatim të kësaj dispozite në rastet e masave të caktuara për qëllime të ekstradimit, duke pasur parasysh natyrën e kësaj dispozite, e cila ka të bëjë me çështje penale të

themelit në kompetencë të gjykatave vendase (*shih vendimin nr. 00-2022-1821 (292), datë 3.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqet 14–16, paragrafët 21–23*).

41. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura nga kërkuesi gjatë procesit gjyqësor përkundjet fakteve dhe provave të marra gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta në raport me rregullimet ligjore që përcaktojnë caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” në rastin e tij. Kjo gjykatë ka analizuar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta, duke argumentuar qëndrimin e saj përmes të cilit i ka gjetur të drejta këto vendimmarrje dhe ka dhënë përgjigje të arsyetuar për vlerësimet e arritura në përfundim të shqyrtimit të çështjes. Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Lartë në rastin konkret nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për rrjedhojë nuk rezulton të ketë cenuar lirinë personale të kërkuesit.

42. Për sa më lart, në kontekst të rrethanave të çështjes në shqyrtim dhe në analizë të procesit gjyqësor të kundërshtuar përmes ankimit kushtetues individual, në aspektin kushtetues Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit është i pabazuar.

43. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, është i pabazuar, ndaj duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 18.10.2023.

Shpallur, më 17.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Ilir Toska, Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Ermal (Arben) Gjokja, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1821 (292), datë 3.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i bazuar, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

2. Pa dashur të përsërisim faktet që kanë rezultuar gjatë këtij gjykimi, të cilat janë pasqyruar në vendim, theksojmë se ato që marrin rëndësi të veçantë në funksion të argumentimit të qëndrimit tonë në këtë çështje janë si vijon.

3. Në kuadër të ekzekutimit të tre vendimeve penale të dënimit me burgim të dhëna nga autoritetet gjyqësore italiane kundër shtetasit shqiptar Arben Gjokja, lindur më datë 1.2.1970, në Shqipëri ka pasur tri procedura gjyqësore. Fillimisht, në vitin 2008, prokuroria ka vënë në lëvizje procedurën e njohjes së vendimeve penale të huaja, procedurë e cila nuk është finalizuar me ndonjë vendim gjyqësor. Në kuadër të kësaj procedure, gjykata e shkallës së parë ka vendosur masën e sigurimit “Arresti në burg” ndaj shtetasit Arben (Ermal) Gjokja, masë shtrënguese kjo që

nuk është zbatuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore ndaj kërkuesit, për shkak se është vlerësuar se nuk është ky shtetas ndaj të cilit duhet ekzekutuar ai vendim, mbështetur në përfundimet e një ekspertimi daktiloskopik të gjurmëve të gishtave të shtetasit të shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe atij për të cilin është caktuar masa e sigurimit (kërkuesit). Më pas, në vitin 2014, Policia Gjyqësore ka bërë arrestimin e përkohshëm të kërkuesit për efekt të ekstradimit në Itali. Edhe në këtë rast është kryer një ekspertim daktiloskopik, ku është arritur në përfundimin e mospërputhjes së gjurmëve të gishtave të personit sipas kartelës së marrë nga policia italiane me ato të personit të arrestuar (kërkuesit). Në këtë procedurë ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur”. Kjo procedurë nuk ka vijuar më tej, duke u pushuar nga prokurori në vitin 2015, me arsyetimin se nga autoritetet italiane nuk është dërguar kërkesa për ekstradim dhe se personi i dënuar nga autoritetet gjyqësore italiane nuk është personi për të cilin ka filluar procedura (kërkuesi).

4. Në vitin 2017, kërkuesi është shoqëruar përsëri në polici, me qëllim arrestimin e tij të përkohshëm, ndërsa vijonte të ishte në kërkim ndërkombëtar. Pavarësisht kësaj, ai nuk është arrestuar, duke mos u filluar ndonjë procedurë ekstradimi, me arsyetimin e mosrealizimit në kohë nga ana e ZQK-së Interpol Roma të krahasimit të gjurmëve të gishtave të kërkuesit me ato të personit të shpallur në kërkim ndërkombëtar. Së fundi, më datë 16.4.2022, sërish Policia Gjyqësore ka bërë arrestimin e përkohshëm të kërkuesit për efekt të ekstradimit në Itali. Edhe në këtë rast është kryer një ekspertim daktiloskopik, ku është arritur në përfundimin e përputhjes së gjurmëve të gishtave të personit sipas kartelës së Interpol Romës me ato të personit të arrestuar (kërkuesit). Kjo procedurë ekstradimi ka vijuar, ku zbatimi i masës së sigurimit “Arresti në burg” në një moment të caktuar të saj, është bërë objekt kundërshtimi nga kërkuesi përpara gjykatave të zakonshme dhe, më pas, edhe përmes ankimit kushtetues individual.

5. Në procedurën e ekstradimit të vënë në lëvizje në vitin 2022, fillimisht, gjykata e shkallës së parë, më datë 20.4.2022, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin e përkohshëm dhe ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, për qëllime të ekstradimit të tij në Itali. Ky vendim ka marrë formë të prerë, ndërsa është miratuar nga gjykata e apelit pas ankimit të kërkuesit. Kjo masë siguri ka vijuar të zbatohet ndaj tij, ndërsa kërkuesi ka dështuar edhe në përpjekjen për revokimin e kësaj mase, mbi pretendimin e mosparaqitjes në kohë të kërkesës për ekstradim nga autoritetet italiane. Edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e kërkesës së kërkuesit ka marrë formë të prerë, pasi është miratuar nga gjykata e apelit pas ankimit të tij.

6. Ndërkohë, kërkesa për ekstradimin e kërkuesit është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë më datë 26.5.2022. Ajo është marrë në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa kërkuesi ndodhej në paraburgim. Gjatë këtij procesi, me kërkesë të prokurorit, më datë 16.7.2022 gjykata ka zgjatur afatin e paraburgimit për kërkuesin për 30 ditë. Më tej, më datë 18.7.2022, gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim të kërkuesit, për disa arsye, mes të tjerash, edhe se nuk provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se personi i dënuar nga gjykatat italiane është i arrestuari Eral (Arben) Gjokja. Ndërkohë, gjykata e shkallës së parë nuk është shprehur për masën e sigurimit të zbatuar ndaj kërkuesit dhe ai ka vijuar të mbahet në paraburgim.

7. Në këto rrethana, me pretendimin se vijimi i mbajtjes së tij në paraburgim binte ndesh me ligjin, po më datë 18.7.2022 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për revokimin, zëvendësimin ose shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe lirimin e tij nga paraburgimi. Më datë 25.7.2022 gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e saj, duke arsyetuar: (i) kërkesa për shuarjen e masës ishte e parakohshme, pasi nuk kishte përfunduar afati i zgjatur i paraburgimit; (ii) vendimi i refuzimit të ekstradimit nuk kishte marrë formë të prerë, pasi është ankimuar nga prokuroria; (iii) kërkesës nuk i ishin bashkëlidhur prova dhe akte për të provuar pretendimet; (iv) ishte i pabazuar pretendimi për zbatimin e nenit 261, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, pasi mospranimi i kërkesës për ekstradim nuk përfaqëson vendim pushimi ose pafajësie; (v) ishte i pabazuar pretendimi se në rastet e moslejimit të ekstradimit nga gjykata e shkallës së parë i arrestuari duhet të lirohet, pasi një gjë e tillë nuk parashikohej në ligj dhe se neni 499, pika 2, i KPP-së nënkupton rastin kur vendimi që refuzon kërkesën për ekstradim është i formës së prerë.

8. Mbi ankimin e kërkuarit, më datë 5.8.2022 gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin: (i) në kuadër të një procedure ekstradimi, masa e sigurimit ndjek kritere ligjore të veçanta dhe vetëm për atë që është e mundur zbatohen dispozitat ligjore mbi caktimin e masave të sigurimit sipas neneve 228 e vijues të KPP-së, pasi qëllimi i zbatimit të masave shtrënguese në kuadër të kësaj procedure është garantimi i dhënies së ndihmës juridike të kërkuar nga shteti kërkuar, e pikërisht mundësia e dorëzimit të personit të kërkuar në eventualitetin e pranimit të kërkesës për ekstradim; (ii) garantimi i mosdorëzimit të pamotivuar të personit që kërkohet të ekstradohet nëpërmjet një vendimi që ka kaluar të tria shkallët e gjykimit sipas ndryshimeve të bëra në KPP me ligjin nr. 35/2017, vlen edhe në të kundërt, pra për sa i përket detyrimit të shtetit të kërkuar për të garantuar dorëzimin e personit të dënuar (në këtë rast), ndaj masa e sigurimit vijon të zbatohet brenda afateve ligjore, deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për ekstradim me vendim të formës së prerë, që si i tillë, përmes nenit 462, pika 3, shkronja “c”, të KPP-së, është përcaktuar vendimi i Gjykatës së Lartë, nëse nga palët është ushtruar rekurs; (iii) neni 261, pika 1, shkronja “a”, i KPP-së bën fjalë për shuarjen e një mase sigurimi të caktuar për llogari të një procedimi penal dhe gjykimi themeli në kompetencë të gjykatës vendase, ndërsa procedura gjyqësore e shqyrtimit të kërkesës për ekstradim është tërësisht e ndryshme, pasi vendimi i dënimit ose i caktimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” u përket autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkuar, ndaj në një procedurë ekstradimi nuk mund të jemi para deklaratimit nga gjykata të një vendimi pushimi ose pafajësie siç përcakton kjo dispozitë; (iv) në rastin e ekstradimit, garancia ligjore e parashikuar për individin është kohëzgjatja e ndryshme e masës së sigurimit në raport me kohëzgjatjen e gjykimit sipas përcaktimeve të nenit 493 të KPP-së, në ndryshim nga përcaktimi i përgjithshëm i bërë në nenin 263 të tij. Për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim, ligji ka përcaktuar afate ligjore rigorozë dhe të shkurtra, prekluzive, në rastet kur ajo shoqërohet me zbatimin e masës së “Arrestit në burg”, ku tejkalimi i këtyre afateve çon në shuarjen e kësaj mase; (v) rrëzimi i kërkesës për ekstradim nuk mund të përbënte shkak për lirimin nga paraburgimi në bazë të nenit 499 të KPP-së, pasi kjo dispozitë nuk kishte lidhje me fazën gjyqësore të shqyrtimit të kërkesës për ekstradim, por i referohet qartësisht fazës pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor që ka lejuar ekstradimin; (vi) përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se i arrestuari nuk ishte personi i dënuar sipas vendimit të gjykatës italiane, nuk mund të përbënte shkak ligjor për shuarjen e masës së sigurimit për sa kohë një gjë e tillë i përkiste shqyrtimit në themel të kërkesës për ekstradim, përveçse një rrethanë e tillë nuk parashikohet në nenin 261, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së ku mbështetet kërkesa për shuarjen e masës së sigurimit; (vii) sipas qëndrimit orientues të mbajtur me vendimin nr. 00-2022-787, datë 5.7.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, neni 261, pika 1, shkronja “a”, i KPP-së nuk gjen zbatim edhe në rastet e një vendimi pafajësie të gjykatës së shkallës së parë, ndaj, atëherë, kjo dispozitë mund të gjejë zbatim në një procedurë të posaçme siç ishte ajo e ekstradimit, qëllimi i së cilës është garantimi i dorëzimit të personit të kërkuar, ku në eventualitet të pranimit të kërkesës, mjafton ky fakt, duke u plotësuar kriteret ligjore, për vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, pasi është evident rreziku i ikjes së personit në proces gjyqësor me qëllim shmangien nga ekstradimi dhe, më tej, nga ekzekutimi i dënimit me burgim.

9. Mbi rekursin e kërkuarit, më datë 3.11.2022 Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, pasi ka gjetur të drejta përfundimet e gjykatës së apelit dhe duke mos marrë parasysh qëndrimin e prokurorit të shprehur para saj për pranimin e rekursit të kërkuarit. Sipas Gjykatës së Lartë, kohëzgjatja e zbatimit të masës së sigurimit, në kuadër të procedurës së ekstradimit, të parashikuar specifikisht në nenin 493 të KPP-së, synon të parandalojë jo vetëm kufizimin e gjatë e të pamotivuar të lirisë së personit të kërkuar, por dhe të garantojë mundësinë e dorëzimit të tij në eventualitetin e pranimit të kërkesës, duke vijuar zbatimin e këtyre masave brenda afateve ligjore për çdo shkallë gjyqësore, deri në marrjen formë të prerë të vendimit për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim. Ky vendim i Gjykatës së Lartë është kundërshtuar nga kërkuari me ankim kushtetues individual dhe është objekt i çështjes në shqyrtim.

10. Ndërkohë, në gjykatën e apelit ka vijuar edhe procesi i ekstradimit dhe me vendimin e datës 13.12.2022, ajo ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për

refuzimin e tij, duke gjetur të drejtë vetëm një nga shkaqet e këtij refuzimi nga gjykata e shkallës së parë, atë të mosidentifikimit të personit për të cilin kërkohej ekstradimi (kërkuesit) me personin e dënuar nga autoritetet gjyqësore italiane. Sipas gjykatës së apelit, prokurori ka dështuar të përmbushë detyrimin sipas nenit 489 të KPP-së, për të shoqëruar kërkesën për ekstradim me të dhëna dhe informacione dokumentare që bënin të mundur identifikimin e saktë të personit të dënuar dhe që duhej të ekstradohej me qëllim vuajtjen e dënimit. Ajo ka vërejtur se tre ekspertimet daktiloskopike nuk janë mbështetur në të njëjtat modele krahasimi, ndërsa në ekspertimin e vitit 2022 si të tilla janë përdorur gjurmë daktiloskopike që nuk i përkasin kartelës që Interpol Roma ka përcjellë për personin e dënuar në korrespondencën me gjykatën e apelit. Pavarësisht qëndrimit të saj për refuzimin e ekstradimit, gjykata e apelit nuk është shprehur për masën e sigurimit ndaj kërkuesit, për rrjedhojë ai ka vijuar të mbahej në paraburgim.

11. Duke vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit për refuzimin e ekstradimit është i formës së prerë, më datë 15.12.2022, kërkuesi ka paraqitur sërish kërkesë për shuarjen, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Më datë 17.12.2022, gjykata e shkallës së parë ka vendosur konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij nga paraburgimi. Pas këtij vendimi kërkuesi rezulton se është liruar nga paraburgimi, por me vendimin e datës 27.3.2023, gjykata e apelit, mbi ankimin e prokurorit, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se jemi para “gjësë së gjykuar”, pasi pretendimet e kërkuesit ishin shqyrtuar më parë, duke u gjetur të pabazuara me vendim gjyqësor përfundimtar (vendimi i datës 3.11.2022 i Gjykatës së Lartë). Për rrjedhojë, ajo ka rrëzuar kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit. Në lidhje me rekursin e kërkuesit të paraqitur ndaj vendimit të gjykatës së apelit, me vendimin e datës 24.7.2023, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si dhe në vendimin e saj të datës 3.11.2022.

12. Ndërkohë, lidhur me procesin e ekstradimit, të vënë në lëvizje me rekurs të prokurorit, më datë 30.6.2023, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit të datës 13.12.2022, duke ia kthyer asaj çështjen për rishqyrtim.

13. Më datë 16.5.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit të datës 3.11.2022, të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit i datës 5.8.2022, i cili, nga ana tjetër, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë të datës 25.7.2022, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për revokimin, zëvendësimin ose shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Ai ka pretenduar, ndër të tjera, edhe cenimin e lirisë personale, për shkak se pas datës 18.7.2022 ka vijuar të mbahet në kushtet e paraburgimit edhe pse gjykata e shkallës së parë, fillimisht, dhe gjykata e apelit, më pas, kanë vendosur refuzimin e ekstradimit të tij. Gjykatat e zakonshme kanë vepruar në shkelje të hapur të parimit të ligjshmërisë, duke e mbajtur në paraburgim, në një kohë që liria personale prevalon në çdo shkallë gjykimi, pavarësisht marrjes formë të prerë ose jo të vendimit lidhur me kërkesën për ekstradim.

14. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, ndërsa pika 2, shkronja “dh”, e këtij neni ka përcaktuar në mënyrë shtuese rastet përjashtimore kur lejohet kufizimi i lirisë, mes të tjerash, në rastet e dëbimit ose të ekstradimit. E drejta e lirisë dhe sigurisë personale gjen mbrojtje edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, në pikën 1, shkronja “P”, të të cilit parashikohet se askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj, mes të cilave për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë ekstradimi. Ndërkohë, neni 28 i Kushtetutës përcakton karakterin gjyqësor të procedurave për caktimin e masave të sigurimit, përfshirë edhe ato sipas nenit 27, pika 2, shkronja “dh”, të Kushtetutës. Këto procedura gjejnë rregullim në dispozitat procedurale penale, me detyrimin që të respektojnë edhe garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor.

15. Në nenin 1 të KEE-së, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, parashikohet se palët kontraktuese zotohen t'i dorëzojnë njëra-tjetrës, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara, ata individë që ndiqen për shkelje të ligjit ose kërkohen nga organet gjyqësore të palës kërkuese për të vuajtur një dënim ose një masë sigurimi. Ndërkohë, neni 18 i Konventës rregullon arrestimin e përkohshëm, në raste urgjente, me kërkesë të palës kërkuese,

ndërsa autoritetet kompetente të palës së kërkuar vendosin për këtë kërkesë në përputhje me ligjin e kësaj pale. KEE-ja nuk përmban dispozita të tjera në lidhje me kufizimin e lirisë së personit që kërkohet të ekstradohet.

16. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, në veçanti ekstradimi për jashtë shtetit, janë rregulluar më hollësisht nga KKP-ja dhe ligji nr. 10193/2009. Sipas nenit 488 të KPP-së, që jep kuptimin e ekstradimit, dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit. Në nenin 493 ky Kod rregullon edhe masat shtrënguese, duke përcaktuar se ndaj personit për të cilin është kërkuar ekstradimi mund të merren masa shtrënguese (*pika 1*), për caktimin e të cilave respektohen dispozitat e titullit V të këtij Kodi, për aq sa mund të zbatohen, duke mbajtur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit (*pika 2*), ndërkohë që këto masa nuk vendosen kur ka arsye të çmohet se nuk ekzistojnë kushtet për dhënien e një vendimi në favor të ekstradimit (*pika 3*). Në pikën 4 të saj kjo dispozitë rregullon edhe kohëzgjatjen e masave shtrënguese dhe revokimin e tyre, duke e lidhur këtë me afatet e përcaktuara për përfundimin e procesit gjyqësor të ekstradimit në secilën nga të tria shkallët e gjyqimit. Ndërkohë, në pikën 5 të saj rregullohet kompetenca për të vendosur në bazë të paragrafëve të mësipërm të kësaj dispozite, duke ia caktuar atë gjykatës së rrethit ose gjatë procedimit para gjykatës së apelit kësaj të fundit. Neni 498 i KPP-së rregullon vendimmarrjen e gjykatës, ku në pikën 3 të tij përcaktohet se kur gjykata jep vendim kundër ekstradimit, ekstradimi nuk mund të bëhet.

17. Në analizë të rrethanave të çështjes konkrete, rezulton se, fillimisht, kufizimi, heqja e lirisë personale të kërkuesit, përmes caktimit të masës shtrënguese “Arresti në burg” me vendimin e gjykatës së shkallës së parë të datës 20.4.2022, është bërë bazuar në faktin se është ai personi për të cilin kërkohet ekstradimi për vuajtjen e dënimit me burgim të caktuar përmes tre vendimeve penale të autoriteteve gjyqësore italiane, duke u plotësuar kështu kriteri i përcaktuar nga neni 27, pika 2, shkronja “dh”, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 1, shkronja “f”, i KEDNJ-së. Në vijim, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për ekstradim, gjykata e shkallës së parë, me vendimin e datës 18.7.2022, ka vendosur refuzimin e ekstradimit të kërkuesit, ndër të tjera, edhe për shkakun se nuk është ai personi i dënuar nga autoritetet gjyqësore italiane sipas kërkesës për ekstradim. Pavarësisht këtij përfundimi, gjykata e shkallës së parë nuk ka disponuar për heqjen e masës së sigurimit dhe lirimin e kërkuesit nga paraburgimi. Në vijim, ajo ka refuzuar kërkesën e tij për lirim nga paraburgimi, duke mos pranuar zbatimin me analogji të ligjit procedural penal për shuarjen e masave në rastin e përfundimit pa sukses të procedimit penal (pushimit të çështjes ose deklarimit të pafajësisë), sipas nenit 261, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së.

18. Ky vendim i gjykatës së shkallës së parë është gjetur i drejtë edhe nga dy gjykatat më të larta, të cilat kanë vlerësuar se personi i arrestuar për qëllime ekstradimi duhet të qëndrojë në paraburgim, sipas afateve ligjore të shqyrtimit të kërkesës për ekstradim për çdo shkallë gjykimi, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të dhënë mbi këtë kërkesë, me qëllim për të garantuar mundësinë e dorëzimit të tij, në eventualitetin e pranimin të kërkesës për ekstradim. Referuar nenit 462, pika 3, shkronja “c”, gjykatat kanë konsideruar si vendim të formës së prerë vendimin e Gjykatës së Lartë, në rast të ushtrimit të rekursit nga palët.

19. Për rrjedhojë, kërkuesi ka vijuar të qëndrojë në paraburgim edhe pas vendimit të gjykatës së apelit të datës 13.12.2022, pavarësisht se ajo e ka gjetur të drejtë refuzimin e ekstradimit nga gjykata e shkallës së parë, për shkakun se nuk është ai personi i dënuar nga autoritetet gjyqësore italiane sipas kërkesës për ekstradim. Kërkuesi është liruar nga paraburgimi vetëm më datë 17.12.2022, pas një vendimi të gjykatës së shkallës së parë që ka konstatuar shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg” për shkak të marrjes formë të prerë të vendimit për refuzimin e kërkesës për ekstradim.

20. Duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, vlerësojmë se në çështjen konkrete evidentohet një rrethanë që meritonte trajtim dhe përgjigje nga Gjykata, që është pikërisht efekti që sjell për fuqinë e masave shtrënguese, pra në drejtim të lirisë personale të individit (kërkuesit) një vendim gjyqësor kundër ekstradimit dhe ekzekutueshmëria e tij.

21. Shumica ka evidentuar në vendim dispozitat ligjore penale që rregullojnë caktimin e

masave shtrënguese për qëllime të ekstradimit. Ajo ka çmuar të vlerësojë në aspektin kushtetues vendimmarrjet e gjykatave në kontekstin e fakteve të çështjes në shqyrtim, nën dritën e standardeve kushtetuese për rastet e kufizimit të lirisë personale të individit. Në këtë drejtim, shumica ka konstatuar se liria e kërkuarit është kufizuar më datë 16.4.2022, kur, bazuar në urdhrin e përditësuar të arrestit ndërkombëtar, ai është arrestuar për qëllime të ekstradimit në shtetin italian (*shih paragrafët 33–38 të vendimit*).

22. Më tej, shumica, duke analizuar, ka vërejtur se në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, Gjykata e Lartë ka vlerësuar interpretimin që gjykatat më të ulëta u kanë bërë dispozitave ligjore të KPP-së që rregullojnë caktimin e masave shtrënguese për qëllime të ekstradimit, për aq sa ato mund të zbatohen, duke pasur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit. Sipas saj, Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura nga kërkuari gjatë procesit gjyqësor përkundjet fakteve dhe provave të marra gjatë gjyqësorit nga gjykatat më të ulëta në raport me rregullimet ligjore që përcaktojnë caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” në rastin e tij. Gjykata e Lartë ka analizuar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta, duke argumentuar qëndrimin e saj përmes të cilit i ka gjetur të drejta këto vendimmarrje dhe ka dhënë përgjigje të arsyetuar për vlerësimet e arritura në përfundim të shqyrtimit të çështjes. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë në rastin konkret nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për rrjedhojë nuk rezulton të ketë cenuar lirinë personale të kërkuarit. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se në kontekst të rrethanave të çështjes në shqyrtim dhe në analizë të procesit gjyqësor të kundërshtuar përmes ankimit kushtetues individual, në aspektin kushtetues, pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit është i pabazuar (*shih paragrafët 39–42 të vendimit*).

23. Në vlerësimin tonë si gjyqtarë në pakicë, duke iu referuar arsyetimit të shumicës në lidhje me pretendimin e kërkuarit për cenimin e lirisë personale, ai është bazuar në trajtimin e përgjithshëm të elementeve me natyrë ligjore, por pa e çuar çështjen në nivel kushtetues, edhe pse ajo mbart specifika dhe problematika të dukshme në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave procedurale penale, të cilat sjellin efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe liritë themelore të individit, veçanërisht duke qenë se ka të bëjë me heqjen e lirisë personale. Shumica duhej të analizonte efektin që vendimi gjyqësor kundër ekstradimit të kërkuarit duhet të sillte për fuqinë e masës së sigurimit “Arresti në burg” të caktuar ndaj tij, pra nëse kërkuari do të duhej të qëndronte në paraburgim pas një vendimi të tillë. Ky trajtim mungon në këtë rast, duke lënë pa përgjigje dhe analizë aspektet kryesore me natyrë kushtetuese të çështjes konkrete. Në vlerësimin tonë ky qëndrim mund të përbëjë për organet gjyqësore një precedent që mund të çojë në kufizimin jokushtetues të të drejtave të individit.

24. Qëndrimi i shumicës, që ka legjitimuar vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme, duket se është pranimi i përfundimit të tyre se neni 462, pika 3, shkronja “c”, i KPP-së përcakton si vendim të formës së prerë në rastet e ekstradimit vendimin e Gjykatës së Lartë dhe se, ndërsa procesi gjyqësor për ekstradim ishte ende në shqyrtim, kërkuari kishte rrezik ikeje për t’iu shmangur ekstradimit dhe vuajtjes së dënimit me burgim të caktuar nga autoritetet gjyqësore italiane.

25. *Së pari*, vlerësojmë se nga shumica nuk është vënë në diskutim qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e bërë në nenin 462, pika 3, shkronja “c”, të KPP-së dhe kuptimit që ai mbart në raport me të drejtat themelore të individit. Në vlerësimin tonë, ky qëllim konsiston në garantimin e së drejtës themelore të individit për mbrojtjen nga ekstradimi, që gjen rregullim në nenin 39, pika 2, të Kushtetutës. Përveç kësaj, përmes atij rregullimi, sigurohet edhe serioziteti i shtetit dhe qëndrueshmëria e raporteve ndërshtetërore në fushën e marrëdhënieve juridiksionale, në veçanti për sa i përket ekstradimit për jashtë. Rregullimi sipas shkronjës “c”, pika 3, të nenit 462 të KPP-së, ndryshe nga sa parashikohet për vendimet e tjera gjyqësore, në rastin e një procesi gjyqësor ekstradimi ka përcaktuar si të ekzekutueshëm vendimin e gjykatës më të lartë në sistemin gjyqësor, tek e cila, si rregull, përmbyllet një proces gjyqësor. Pavarësisht teknikës së përdorur për formulimin e rregullit, ai nuk mund të interpretohet se procesi i ekstradimit do të duhet patjetër t’i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Lartë, pasi një kontroll i tillë mund të ushtrohet vetëm nëse

palët bëjnë ankim, çka është e drejtë, por jo detyrim i tyre. Në këtë kuptim, vlerësojmë se ekzekutueshmëria, që bën fjalë neni 462, pika 3, shkronja “c”, i KPP-së, lidhet vetëm me një vendim në favor të ekstradimit, i cili, në kuptim të nenit 39, pika 2, të Kushtetutës, duhet të jetë një vendim përfundimtar (*res judicata*). Nga ana tjetër, në një vendim kundër ekstradimit në thelb nuk ka çfarë të ekzekutohet, përveç efekteve të tij për sa u përket masave të sigurimit.

26. *Së dyti*, duket se shumica i ka dhënë vlerë dyshimit për rrezikun e ikjes së kërkuesit për t’iu shmangur ekstradimit, në një kohë kur vetë gjykata e zakonshme ka vendosur kundër ekstradimit të tij. Sipas nenit 261, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, masat e sigurimit shuhën në rastin e përfundimit pa sukses të procedimit penal para gjykatës (pushimit të çështjes ose deklarimit të pafajësisë). Kjo dispozitë, e kombinuar me përcaktimin e bërë në nenin 493, pika 2, të KPP-së, të çon në përfundimin logjik se edhe në rastin e përfundimit pa sukses të procesit gjyqësor të ekstradimit, masat e sigurimit shuhën. Si dhe më lart u parashtrua, neni 462 i KPP-së rregullon vetëm situatën e vënies në ekzekutim të vendimit në favor të ekstradimit, ndërsa nuk ka rregullim specifik për ekzekutueshmërinë e një vendimi gjyqësor kundër ekstradimit, çka në fakt implikon vetëm efektet që ai sjell për fuqinë e masave të sigurimit. Nisur nga kjo, për analogji vlen të konsiderohet rregullimi i bërë nga kjo dispozitë (*pika 2*) për ekzekutueshmërinë e vendimeve gjyqësore që kanë disponuar kundër procedimit penal. Nëse do të pranohej e kundërta, pra se ligji nuk parashikon ekzekutueshmërinë e një vendimi gjyqësor kundër ekstradimit, atëherë do të duhet të pranohet se personi nën masa sigurimi për qëllime ekstradimi vazhdon t’iu nënshtrohet këtyre masave, pavarësisht se me vendim përfundimtar/të përvokueshëm/*(res judicata)* gjykata ka disponuar kundër ekstradimit. Në vlerësimin tonë, mosvënia në ekzekutim e një vendimi gjyqësor kundër ekstradimit, mbart në vetvete mungesën e përligjjes kushtetuese të vijimit të kufizimit të lirisë së personit.

27. Neni 493, pika 3, i KPP-së përcakton qartë se masat shtrënguese nuk vendosen kur ka arsye të çmohet se nuk ekzistojnë kushtet për dhënien e një vendimi në favor të ekstradimit, për rrjedhojë vazhdimi i zbatimit të tyre nuk mund të përligjet kur gjykata jep vendim kundër ekstradimit. Qenia i ankimeshëm nga prokurori i vendimit kundër ekstradimit dhe vijimi i procesit gjyqësor të ekstradimit nuk përbëjnë arsye ligjore, aq më pak kushtetuese dhe konventore, për vazhdimin e kufizimit të lirisë së një personi për të cilin gjykata ka vendosur kundër ekstradimit të tij. Shumica, duke mos gjetur probleme në interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, duket sikur ka shkuar drejt pohimit të bërë nga ato se individit mund t’i nënshtrohet kufizimit të lirisë për sa kohë nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë/të përvokueshëm/*res judicata* kundër ekstradimit të tij, çka në mënyrë të palogjikshme shkon në dëm të drejtave themelore të individit. Parimi kushtetues i mëshiruar në nenin 27, pika 1, të Kushtetutës ndalon heqjen e lirisë së individit, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, i cili, nga ana tjetër, parashihet burgosjen e individit vetëm me vendim gjykatë. Në këtë kuptim, ne vlerësojmë se, ndërsa interpretimi i zgjeruar lejohet vetëm në aspektin pozitiv, pra kur shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit, në rastin e rrethanave që lejojnë kufizimin e lirisë, ashtu siç thekson edhe GJEDNJ-ja, atyre duhet t’u jepet një interpretim i ngushtë/kufizuar, duke pasur parasysh faktin se përbëjnë përjashtime nga një prej garancive më themelore, asaj të lirisë individuale (*shih Belozorov kundër Rusisë dhe Ukrainës, nr. 43611/02, § 111, datë 15 tetor 2015*).

28. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në nenet 15 dhe 42 të Kushtetutës, kanë detyrimin kushtetues të respektojnë dhe të kontribuojnë për realizimin e të drejtave kushtetuese individuale, çka nënkupton se vendimi për dhënien e një mase të tillë, që kufizon lirinë e individit, duhet të jepet në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor dhe gjykimi nuk duhet të jetë arbitrar. Në rastin konkret, qëndrimi i gjykatave të zakonshme është në kufijtë e një interpretimi arbitrar të ligjit procedural, siç është argumentuar më sipër, me pasojë cenimin e lirive themelore, përveçse, në aspektin e parimit të sigurisë juridike, ka sjellë edhe cenimin e pritshmërive të ligjshme të kërkuesit, në kuptim të nenit 462 të KPP-së, për sa i përket zbatimit të vendimit gjyqësor kundër ekstradimit lidhur me efektet e tij në drejtim të shuarjes së masës së sigurimit.

29. Gjatë veprimtarisë gjyqësore gjyqtari i zakonshëm duhet të lexojë edhe përmbajtjen e normës kushtetuese në të njëjtën mënyrë siç vepron me normat e tjera parësore ose dytësore,

duke pasur detyrimin t'i zbatojë dhe interpretojë këto të fundit në frymën e Kushtetutës. Kjo bën që roli i gjykatës së ligjit të zgjerohet dhe transformohet, edhe pse në thelb ajo ruan funksionin e saj tradicional që lidhet me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, duke synuar individualizimin dhe interpretimin e drejtë të "normave të së drejtës". Kjo e bën Gjykatën e Lartë të zhvendoset nga teksti i normës ligjore drejt të drejtave themelore, duke arritur që nëpërmjet funksionit të saj të bashkojë sigurinë e së drejtës me mbrojtjen e të drejtave të individit. Në situatën që çështja ka të bëjë me zbatimin e dispozitave procedurale që rregullojnë institute të ndryshme të së drejtës, pasur në konsideratë qëndrimin e mbajtur nga prokurori përpara saj, por edhe praktikën gjyqësore të deritanishme, mendojmë se, nga njëra anë, i takonte Gjykatës së Lartë, që në përputhje me kompetencat e saj si gjykatë e ligjit, por edhe në zbatim të parimit të subsidiaritetit, të vinte në diskutim mënyrën e interpretimit të këtyre dispozitave dhe, nëse ishte e nevojshme, të mbante një qëndrim njëses dhe, nga ana tjetër, i takonte kësaj Gjykate që të vlerësonte nëse interpretimi i bërë nga gjykatat e zakonshme ishte në përputhje me garancitë kushtetuese që duhet të respektohen për kufizimin e lirisë së individit.

30. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar, duke u shfuqizuar vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë objekt kërkeje, i cili ka ligjëruar vendimet e gjykatave më të ulëta që kanë refuzuar shuarjen e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" ndaj kërkuarit, në kushtet kur ndaj tij kishte një vendim gjyqësor të ekzekutueshëm me të cilin është disponuar kundër ekstradimit të tij, duke shuar, për rrjedhojë, edhe masën e sigurimit të dhënë në fillim të procedurës së ekstradimit.

Anëtarë: Sandër Beci, Ilir Toska